

**KODI I ETIKËS**  
**I**  
**SHOQËRINË AKSIONARE “IDENTITEK” SHA**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

1. Kod i Etikës ka për qëllim përcaktimin dhe promovimin e standardeve të larta të sjelljes dhe etikës profesionale për të gjithë punonjësit e shoqërisë Identitek sh.a. gjatë ushtrimit të detyrave të tyre.

2. Ai synon të sigurojë që veprimet dhe vendimet e punonjësve të jenë në përputhje me aktet ligjore, nënligjore dhe rregullat e brendshme të shoqërisë, duke ruajtur integritetin, ndershmërinë dhe përgjegjshmërinë profesionale.

**Neni 2**  
**Fusha e zbatimit**

1. Dispozitat e Kodit të Etikës zbatohen për të gjithë individët dhe grupet e mëposhtme, të cilët kanë marrëdhënie pune ose bashkëpunimi me shoqërinë Identitek sh.a.:

a) Të gjithë punonjësit e punësuar pranë Identitek, duke përfshirë:  
- Punonjësit me kohë të plotë;  
- Punonjësit me kohë të pjesshme;  
- Praktikantët dhe stazhierët që kryejnë periudha praktike pranë shoqërisë;  
- Punonjësit e angazhuar në zyrën qendrore dhe në të gjitha zyrat e aplikimit të shoqërisë.

b) Ekspertët dhe profesionistët e angazhuar nga Identitek për detyra specifike dhe për çështje të veçanta, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

c) Çdo person tjetër që vepron në emër të Identitek ose bashkëpunon me të, për aq sa janë të angazhuar në aktivitetet dhe detyrat e shoqërisë.

2. Ky Kod i Etikës është i detyrueshëm për të gjithë personat e lartpërmendor dhe shërben si udhëzues për të siguruar sjellje etike dhe profesionale në çdo aspekt të veprimtarisë së tyre, duke kontribuar në mbarëvajtjen dhe integritetin e shoqërisë.

**Neni 3**  
**Baza ligjore**

1. Ky Kod Etike është hartuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”; Ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”; Ligjin Nr.

44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”; Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”; Statutin e Shoqërisë Identitek sh.a.; si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore të zbatueshme në fushën e veprimitarisë së shoqërisë.

2. Kodi synon të sigurojë pajtueshmërinë e veprimeve dhe vendimeve të shoqërisë dhe punonjësve të saj me kuadrin ligjor dhe rregullator të Republikës së Shqipërisë, duke promovuar standarde të larta etike dhe profesionale.

#### **Neni 4** **Parimet bazë të etikës**

1. Punonjësit e shoqërisë ushtrojnë kompetencat e tyre profesionale, duke u udhëhequr nga këto parime:

- a) Parimi i ligjshmërisë;
- b) Parimi i mosdiskriminimit;
- c) Parimi i korrektësisë;
- ç) Parimi i pavarësisë;
- d) Parimi i konfidencialitetit.

#### **Neni 5** **Parimi i ligjshmërisë**

1. Të gjithë punonjësit e shoqërisë Identitek sh.a. janë të detyruar të zbatojnë dhe të respektojnë me përpikëri të gjitha ligjet dhe rregulloret që rregullojnë veprimitarinë e shoqërisë, duke siguruar që ato të zbatohen në mënyrë të drejtë dhe korakte.

2. Punonjësit duhet të janë të informuar në lidhje me ligjet dhe rregulloret përkatëse dhe t'i zbatojnë ato në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre gjatë ushtrimit të detyrave, duke siguruar përputhshmërinë dhe përkushtimin ndaj standardeve të larta profesionale dhe etike.

#### **Neni 6** **Parimi i mosdiskriminimit**

1. Punonjësit e shoqërisë Identitek sh.a. janë të detyruar të trajtojnë të gjithë individët me barazi dhe respekt, pa marrë parasysh gjininë, fenë, origjinën etnike, gjuhën, orientimin seksual apo karakteristika të tjera personale.

2. Punonjësit duhet të sigurojnë që çdo vendim dhe veprim i ndërmarrë, përfshirë trajtimin e ankesave dhe marrjen e vendimeve, respekton parimin e barazisë dhe nuk favorizon apo diskriminon asnjë individ për shkak të karakteristikave personale. Çdo veprim duhet të jetë i drejtë dhe i paanshëm, duke promovuar një mjesid të barabartë dhe gjithëpërfshirës për të gjithë.

**Neni 7**  
**Parimi i korrektësisë**

1. Punonjësit e shoqërisë Identitek sh.a. ushtrojnë detyrat e tyre me korrektësi dhe ndershmëri, duke respektuar të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi, për të siguruar zbatimin efektiv të politikave të shoqërisë.

2. Punonjësit sigurojnë që veprimet e tyre të janë të rregullta dhe të drejta, në përputhje me standarde etike dhe ligjore të shoqërisë, duke kontribuar në ruajtjen e integritetit dhe besueshmërisë së shoqërisë Identitek sh.a.

**Neni 8**  
**Parimi i pavarësisë**

1. Punonjësit e shoqërisë Identitek sh.a. nuk duhet të ndikohen nga interesat e tyre personale apo të tjerëve në vendimet profesionale. Ata duhet të mbështeten në aftësitë dhe gjykimin e tyre përfundimtar detyrat me profesionalizëm.

2. Punonjësit duhet të sigurojnë që vendimet e tyre të janë të pavarura dhe të bazuara në standarde të larta të integritetit, duke përmbrushur detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në mënyrë objektive dhe të paanshme.

**Neni 9**  
**Parimi i konfidencialitetit**

1. Punonjësit e shoqërisë Identitek sh.a. janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e informacionit të shoqërisë që ata kanë akses, duke mos e zbuluar ose publikuar atë paleje të nevojshme.

2. Punonjësit marrin masa për mbrojtjen e informacionit nga aksesimi i paautorizuar, për të mbrojtur integritetin dhe reputacionin e shoqërisë.

**Neni 10**  
**Rregullat e sjelljes dhe detyrime të tjera**

1. Punonjësit duhet të janë të ndershëm dhe të përkushtuar në kryerjen e detyrave, duke zbatuar me përpikëri aktet ligjore dhe rregullat e disiplinës në vendin e punës.

2. Punonjësit duhet të ruajnë dinjitetin dhe reputacionin e tyre, duke shembangur veprime që mund të dëmtojnë imazhin e shoqërisë.

3. Veshja e punonjësve duhet të jetë serioze dhe profesionale, duke përmbrushur kërkesat për takime zyrtare.

## Neni 11

### Deklarimi i konfliktit të interesit

- 1. Regjimi juridik i konfliktit të interesit përcaktohet sipas ligjit të posaçëm.
- 2. Në rastet e konfliktit të interesit, punonjësit duhet të deklarojnë konfliktin dhe të marrin masa për zgjidhjen e tij, duke vepruar në përputhje me ligjin dhe rregulloren e brendshme të shoqërisë.

## Neni 12

### Ndalimi i diskriminimit

Ndalohet diskriminimi në bazë të karakteristikave personale si gjinia, feja, origjina etnike, ngjyra, gjuha, orientimi seksual, mosha, arsimi, dhe gjendja sociale, në përputhje me legjislacionin përkatës.

## Neni 13

### Ndalimi i ngacmimit seksual

Ndalohet ngacmimi seksual në ambientet e punës, duke mbrojtur punonjësit nga sjelljet që shkaktojnë ankth dhe frikë.

## Neni 14

### Aktivitete të tjera të ndaluara

Ndalohet angazhimi në aktivitete politike apo propagandistike që cenojnë interesat dhe imazhin e shoqërisë.

## Neni 15

### Dhuratat apo përfitimet

- 1. Është e ndaluar marja e dhuratave ose favorizimeve për shkak të pozicionit të punonjësit në shoqëri. Çdo formë dhurimi apo favorizimi që mund të prekë pavarësinë dhe integritetin e punës duhet të shihet si shkelje e rregullave të etikës profesionale.
- 2. Punonjësit duhet të jenë të përgatitur për të identifikuar, dokumentuar dhe raportuar çdo veprim të dyshimtë që dëmton integritetin e shoqërisë dhe interesat e saj legitime, duke adresuar çdo tentativë për korruptim.

**Neni 16**  
**Sinjalizimi**

- 1. Punonjësi i cili beson se i kërkohet të veprojë në një mënyrë jo të ligjshme, të papërshtatshme ose jo etike, që përfshin keqadministrimin, praktikë korruptive ose që bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe Rregulloren e shoqërisë, duhet të raportojë këtë rast pranë njësisë përgjegjëse për sinjalizimin në përputhje me legjislacionin në fuqi për sinjalizimin.
- 2. Në rast evidentimi të shkeljeve të dispozitave të këtij Kodi Etike nga punonjësit e shoqërisë, sinjalizuesi i përcaktuar sipas legjislacionit për sinjalizimin duhet t'i raportojë autoritetit përgjegjës rastin, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 3. Njësia përgjegjëse për sinjalizimin duhet të garantojë ruajtjen dhe trajtimin e rastit në përputhje me legjislacionin në fuqi, pa paragjykuar punonjësin i cili sinjalizon mbi baza të arsyeshme dhe në mirëbesim.

**Neni 17**  
**Detyrimi i njohjes së të drejtave dhe detyrimeve**

Të gjithë punonjësit janë të detyruar të njohin dhe të respektojnë të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në Kodin e Etikës të shoqërisë.

**Neni 18**  
**Sanksionet**

Shkeljet e Kodit të Etikës përbëjnë arsyé për procedura disiplinore sipas rregullores së brendshme të shoqërisë, përvèç rasteve kur shkelja konsiderohet vepër penale.

**Neni 19**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Kod Etike hyn në fuqi me miratimin nga Asambleja e Përgjithshme.

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSME  
AKSIONARI I VETËM  
MINISTRIA E BRENDSHME**

**MINISTRI I BRENDSHËM  
TAULANT BALLA**



The circular stamp contains the text "MINISTRIA E BREDHSHME" around the top and bottom edges, and "REPUBLIKA E SHQIPERISE" around the left and right edges. In the center is the coat of arms of Albania.